

URDHËR
Nr. 833, datë 21.10.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E
HUNGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:
 - a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
 - b) zogjve 24-orësh;
 - c) shpendëve dekorativë;
 - ç) materialit biologjik të shpendëve;
 - d) vezëve të shpendëve;
 - dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
 - e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht,nga shteti i Hungarisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	* Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
<i>Nógrád</i>	<i>Salgótarján*</i>	
<i>Békés</i>	<i>Sarkad*</i>	
<i>Szabolcs-Szatmár- Bereg</i>	<i>Tiszaavasvári*</i>	
<i>Szabolcs-Szatmár- Bereg</i>	<i>Nyírbátor*</i>	
<i>Szabolcs-Szatmár- Bereg</i>	<i>Mátészalka*</i>	
<i>Jász-Nagykun- Szolnok</i>	<i>Tiszafüred*</i>	
<i>Komárom-Esztergom</i>	<i>Komárom*</i>	
<i>Békés</i>	<i>Szeghalom*</i>	
<i>Jász-Nagykun- Szolnok</i>	<i>Kunszentmárton*</i>	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.
3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të pa trajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.
4. Urdhri nr. 804, datë 9.10.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Hungarisë”, shfuqizohet.
5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave

Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj